REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni Ekonomisë dhe Shërbimeve Sociale
të Këshillit Bashkiak Has

RAPORT VENDIMMARRJE
Nr. 12 **datë** 03/09 **2025**

Drejtuar: **Këshillit të Bashkisë**

Lenda: **Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit per Planin e Integritetit**

Komisioni i Ekonomisë dhe Shërbimeve Sociale të Këshillit Bashkiak Has, në mbledhjen e tij, shqyrtoi dhe analizoi Planin e Integritetit të Bashkisë Has . Pas vlerësimit të dokumentacionit dhe bazës ligjore, komisioni thekson se ky plan është një instrument strategjik për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e rolit të gruas në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike.

BAZA LIGJORE

Hartimi dhe miratimi i Planit të Integritetit mbështetet në legjislacionin nëfuqi, përfshirë:
Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i cili përcakton funksionet dhe detyrat e njësive të qeverisjes vendore në ofrimin e shërbimeve dhe forcimin e transparencës e llogaridhënies.
Ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, i cili kërkon respektimin e parimeve të etikës dhe integritetit në administratën publike.
Ligjin nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".
Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2023–2030 dhe Udhëzimet e Agjencisë Kundër Korrupsionit në nivel vendor për hartimin e Planeve të Integritetit.

QËLLIMI DHE RËNDËSIA E PLANIT TË INTEGRITETIT

Plani i Integritetit është një instrument thelbësor për të parandaluar dhe menaxhuar Rreziqet që lidhen me korrupsionin, keqadministrimin apo abuzimet në administratën vendore.
Ky plan:
Identifikon praktikat me risk të lartë për integritetin institucional;
Parashikon masa parandaluese dhe korrigjuese për çdo risk të identifikuar;
Forcon kulturën e etikës dhe përgjegjshmërisë në administratë;
Rrit besimin e publikut në institucionet vendore dhe përmirëson cilësinë e shërbimeve.

Përfundime dhe Rekomandime

Komisioni i Ekonomisë dhe Shërbimeve Sociale, pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe bazën ligjore, bazuar edhe ne degjesen publike te realizuar per kete qellim, arrin në përfundimin se Plani i Integritetit është një domosdoshmëri për zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të Bashkisë Has. Ky plan kontribuon në forcimin e rolit të gruas, rritjen e mundësive të barabarta dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët.

Në këtë kuadër, Komisioni i Ekonomisë dhe Shërbimeve Sociale i propozon Këshillit Bashkiak Has miratimin në tërësi të Planit Integritetit.

Kryetari i Komisionit të Ekonomisë dhe Shërbimeve Sociale: Shkelqim Myrtaj

Anëtarët e Komisionit: Arminda Jashari

Klodiana Hoxhi

Bimole Pefkovic